



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosova**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

**FTESË PËR SHPREHJE TË INTERESIT**

**Për pjesëmarrje të Ekspertëve në Njësine Implementuese për Implementimin/Menaxhimin e projektit të ndërtimit të rrugës Milloshevë - Mitrovicë, dhe Zgjerimi I Rrugëve Rajonale.**

Projektit i ndërtimit të rrugës nacionale N2, segmenti Milloshevë - Mitrovicë dhe Zgjerimi I Rrugëve Rajonale ( hyrja e Prizrenit, hyrja e Ferizajit, Hyrja e Gjilanit dhe rruga Kllkot Gjilan), është prioritet i Republikës së Kosovës. Këto projekte janë duke u financuar në kuadër të Kredisë nga Fondi Saudit për Zhvillim (SFD), OFID- dhe nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD/BERZh).

Procedurat e implementimit të projekteve do të jenë ato të Fondit Saudit për Zhvillim (SFD), OFID- dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), projektet janë duke u realizuar dhe do të zgjasin dy vite.

Si pjesë e marrëveshjeve të Kredisë, parashihet që të formohet Njësia për Implementimin e projektit . Kjo Njësi do të jetë në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ,dhe do të ketë ekspert të profilit teknik, mjedisor , financiar dhe të shpronësimit. Njësia Implementuese do të bëjë menaxhimin e të gjitha fazave të projektit nga aspekti teknik, financiar dhe mbrojtjes së mjedisit.

Duke u bazuar në kompleksitetin e implementimit të projektit , volumit të punëve , Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës fton Ekspertët e Interesuar që të dorëzojnë në formë elektronike dhe kopje të fortë CV-të e tyre, me përshkrim të shkurtër të përvojës së tyre paraprake dhe interesit të tyre për projektin, për këto dy profile të ekspertit :

1. Ekspert I Financave - 1 pozitë
2. Ekspert për Kontroll të Kualitetit (QC & QA)- 1 pozitë

## 1. Ekspert i Financave

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Siguron mbeshtetje për ekzekutimin financiar të projektit në bazë të marrëveshjes me kreditorët nderkombëtar;
- Përgatitë dokumentacionin e nevojshëm për ekzekutimin e pagesave duke u bazuar në rregullat mbi projektet të financuara nga Institucionet Nderkombëtare Financiare (IFI);
- Përgatitë dokumentacionin për disbursim të mjeteve financiare (WA) nga kreditorët e projektit
- Përgatitë për ekzekutim pagat e stafit të Njesisë për Menaxhimin e Projektit, përllogaritë dhe përgatitë për ekzekutim tatimin në të ardhurat personal dhe kontributin pensional për zyrtarët e Njesisë;
- Përgatitë raporte progresive financiare për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit, Ministrinë e Financave dhe Transfereve; dhe për Institucionet Financiare Nderkombëtare (BERZH, OPEC Fund dhe SFD),
- Mirëmban regjistrin e pagesave të ekzekutuara dhe përgaditë parashikimet për pagesat në vijim
- Regjistrimi i faturave blerjes dhe mbajtje të cdo evidence lidhur me pagesat e Njesisë
- Identifikon problemet që lidhen më menaxhimin financiar të projektit, perpilon rekomandime dhe zgjidhje, mbikëqyrë korigjimin e tyre;
- Ndjek operacionet e përditëshme të financiare për projektin;
- Mbeshtet Auditimin financiar të projekti, siguron të gjitha të dhënat financiare për shqyrtim nga ana e auditorëve të jashtëm
- Përkujdeset për ruajtjen dhe fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të dhënave që i merr në fushën përkatëse;
- Raporton rregullisht te Drejtori i Njesisë rreth progresit financiar në lidhje me planet e miratuara të punës;
- Kryen detyra të tjera të ndërlidhura të caktuara nga udhëheqësi.

### ***Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:***

- Diplomë universitare -bachelor, Fakulteti Ekonomik.
- Minimum 5 (dhjetë) vite përvojë pune profesionale
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në Republikën e Kosovës që rregullojnë fushën e financimit të projekteve
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion
- Aftësi të mira komunikuese, njohje e avancuar e gjuhës Angleze në të folur dhe shkruar
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacionet e programeve (Word, Excel, Power Point, Acces,etj.

## 1. Ekspert për Kontroll të Kualitetit (QC & QA)

### *Detyrat dhe përgjegjësit:*

- Kontribon në identifikimin, zbatimin dhe monitorimin e mbështetjes ditore për aktivitetet e projektit duke përfshirë pajtueshmërinë e kontratës, menaxhimin e riskut, shëndetin dhe sigurinë, menaxhimin financiar dhe raportimin, kontrollin e dokumenteve, sigurimin dhe qeverisjen, për të siguruar respektimin e standardeve të Autostradave Europiane.
- Shqyrton dhe vlerëson kërkesat e Inxhinierëve të Pavarur dhe Kontraktorëve të Projekteve dhe palëve që mund të dalin gjatë realizimit të punimëve;
- Kryen monitorime të rregullta ne teren për verifikimin se a zbatohet projekti dhe kushtet teknike gjatë realizimit të punimëve;
- Përcjellja e punimeve të laboratorëve dhe shërbimeve tjera për realizimin e projektit dhe kujdesit për kontrollin e kualitetit dhe cilësis sipas normave dhe stardardeve.
- Marrja pjesë në cilësinë e ekspertit në komisione teknike të formuara nga menaxheri i Njësisë;
- Zgjidhja e çështjeve profesionale që do të dalin gjatë punimëve;
- Pjesëmarrja në takimet me kontraktuesit, mbikqyrësit, projektuesit dhe subjektet e ndryshme;
- Jep këshilla profesionale Menaxherit të Njësisë;
- Mirëmbanë planin e punës së projektit dhe operimet e buxhetit, siç kërkohet;
- Verifikon certifikatat për pagesë të dorëzuara nga Inxhinierët e Pavarur dhe Kontraktorë e Projektit;
- Dërgon raporte të rregullta Menaxherit të Njësisë për gjendjene e realizimit të punimëve;
- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga Menaxheri i Njësisë;

### *Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara*

- Diploma Universitare: Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës; Inxhinier i ndërtimtarisë, Master I shkencave të inxhinierisë për menaxhimin e ndërtimit
- Eksperiencë pune profesionale të vazhdueshme (min 10 vjeçare) në institucionet ndërkombëtare, publike ose private.
- Eksperiencë pune së paku 5 vjeçare në projekte të financuara nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare, ku janë aplikuar rregullat e FIDIC-ut;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze në të folur dhe shkruar;
- Njohuri të programeve profesionale Auto Cad, MS Project, Word, Excel etj;
- Të ketë aftësi/shkathtësi të mira menaxheriale, mbikëqyrës, të zgjidhjes së problemëve, të komunikimit , të menaxhimit të kohës dhe të organizimit të punëve;
- Përvojë për punë ekipore.

Ftohen të gjithë të Interesuarit që të Dorëzojnë Shprehjen e Interesit me të dhënat e tyre (CV), afati I dorëzimi të CV's është 15 ditë nga dita e shpalljes ,deri me datë **20.02.2024**, në ora 16:00. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës do të përpiloj Listën e Shkurtë të Kandidatëve e cila do ti dërgohet për Miratim Fondit Saudit për Zhvillim (SFD), OFID- dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD).

**Paraqitja e kandidatëve:**

Udhëheqësi i Divizionit të Personelit: znj.Lindita Osaj

email: lindita.osaj@rks-gov.net

nr.tel: 038/200 28547

**Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Rr. Nëna Terezë , Ndërtesa e ish-Gërmisë, kati II - zyra A 204/**

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.